



REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE

Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës në pajtim me Rregulloren MF - Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve (13 qershor 2017) dhe Udhëzimit Administrativ (SZP) Nr. 04/2021 për Ndarjen e Subvencioneve në Presidencë (26 gusht 2021), hap:

**THIRRJE PUBLIKE PËR OFRIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR
FINANCIMIN E PROJEKTEVE/PROGRAMEVE PËR PERSONA FIZIK DHE OJQ**

Kjo thirrje publike bëhet më qëllim të mbështetjes financiare të projekteve apo programeve të propozuara nga personat fizik dhe OJQ-të, e të cilat janë të fokusuara në fushat si në vijim:

- mbrojtja e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut;
- çështje gjinore dhe integrim socio - ekonomik;
- shëndeti dhe mirëqenia e gruas;
- çështje me interes për personat me nevoja të veçanta.

Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme minimale, si në vijim:

- objektivat e projektit/programit të jenë të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe realisht të arritshme;
- aktivitetet e projektit/programit të jenë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- kostot e projektit/programit të jenë reale në lidhje me rezultatet specifike dhe kohëzgjatjen e pritshme të projektit.
-

Personat fizik dhe OJQ-të, mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje publike.

Të drejtë aplikimi me projektet/programet e tyre kanë personat fizik dhe OJQ-të, që dëshmojnë se projekti/programi i tyre është i fokusuar në njërën nga fushat e kësaj Thirrje Publike.

Personat fizik dhe OJQ-të obligohen që t'i kryejnë transaksionet financiare për realizimin e projektit për të cilin kanë përfituar mbështetjen financiare nga Zyra e Presidentes në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të përmbushin detyrimet kontraktuale të krijuara deri në përfundim të programit/projektit të paraqitura edhe në kontratë.

Kërkesat dhe propozimet do të dorëzohen vetëm në formularin e aplikimit, i cili është në dispozicion në ueb-faqen e Presidencës: <https://president-ksgov.net/sq/shpallje>

- Dokumentet duhet të dorëzohen fizikisht në **dy (2) kopje**.
- Dokumentet e kompletuara nuk do të pranohen përmes postës elektronike.
- Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht ose me postë, në adresën e mëposhtme:

Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës
Sheshi Nëna Terezë, Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Zyra e Arkivit, Nr. N 319,
10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Aplikimi i personave fizik dhe OJQ-ve, do të konsiderohet i plotë nëse e ka të plotësuar të gjithë dokumentacionin përkatës siç kërkohet në thirrje publike, si në vijim:

- Formularin e plotësuar të aplikimit, ku përfshihet pjesa narrative dhe financiare e kërkesës;
- Kopjen e dokumentit të regjistrimit në organin kompetent, për OJQ-të;
- Kopjen e dokumentit të vlefshëm identifikues, në rast të aplikimit nga personi fizik;
- Kopjen e dokumentit identifikues të personit të autorizuar që përfaqëson OJQ-në;
- Certifikatën valide të numrit fiskal - (dëshmia e validitetit përmes vërtetimit tatimor);
- Vërtetimin e llogarisë bankare aktive.

Shuma totale e alokuar për këtë thirrje publike është 250,000 (dyqind pesëdhjetëmijë EURO).

Procesi i pranimit të aplikacioneve, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e subvencionit, koha dhe mënyra e paraqitjes së ankesave, si dhe monitorimi i realizimit të projekteve, do të bëhen sipas Rregullores MF - Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe Udhëzimit Administrativ (SZP) Nr. 04/2021 për Ndarjen e Subvencioneve në Presidencë.

Vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe që i përmbushin në tërësi kushtet e përcaktuara të thirrjes publike do të shqyrtohen për mbështetje financiare.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune nga dita e publikimit dhe përfundon më 17.10.2023.

Për çdo paqartësi lidhur me thirrjen publike mund të jepen sqarime vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: subvencione.zprk@president-ksgov.net, **deri më datën 03.10.2023.**